

VENDIM
Nr. 42, datë 24.11.2016

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “TIRONA”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Tirona”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 4 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët në shoqërinë e kursim-kreditit “Tirona”, u konstatua se:

- a) në sistemin informatik mungonte moduli për llogaritjen e primit;
- b) mungonin të dhëna të sakta për depozitat dhe depozituesit;
- c) mungonte dokumentacioni i domosdoshëm për mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve për hapjen dhe transaksionet financiare me depozitat.

4. Gjendja financiare e shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” ishte e paverifikueshme për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

5. Mungonte tërësisht dokumentacioni për funksionimin e strukturave drejtuese.

6. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” ishte në konflikt gjyqësor me Union Shqiptar të Kursim-Kredisë lidhur me të drejtat dhe detyrimet përkatëse si pasojë e shkëputjes së kësaj shoqërie nga Unioni.

7. Në vijim të kërkesës së shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” pranë Bankës së Shqipërisë dhe pretendimit mbi përmbushjen e kushteve, grupi i verifikimit në datën 14 tetor 2016, kreu një proces tjetër verifikimi. Në përfundim të këtij procesi u konstatua se problematikat ishin të njëjta me ato të evidentuara në verifikimin e datës 4 korrik 2016.

8. Në muajin gusht 2016, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ishin regjistruar katër urdhra për vendosjen e sekuestros konservative mbi shoqërinë e kursim-kreditit “Tirona” nga kompani përmbarrimore.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-

kreditit “Tirona”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR
Donald Duraj